



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



NJOFTIM

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 67, pika 1, si dhe mbështetur në Statutin e Universitetit të Tiranës, kërkon të punësojë për 6 (gjashtë) vende pune për personel akademik me kohë të plotë, kategoria "Asistent – lektor" në Departamentin e Gjuhës Angleze pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja:

- **Personel akademik me kohë të plotë, kategoria "Asistent-Lektor", 6 (gjashtë) vende pune**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare 4–vjeçare ose 3 + 2 vjeçare në fushën e gjuhës angleze;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna;

Kritere të veçanta:

1. Të ketë diplomë universitare në dy cikle të studimeve:
 - a. Diplomë e integruar e nivelit të dytë (sistemi 4-vjeçar) në drejtimet Mësues i Gjuhës Angleze për shkollën e mesme, Përkthim dhe Interpretim, Studime Britanike e Amerikane, notë mesatare mbi 9;
 - b. Cikli i Parë i Studimeve në Gjuhë Angleze (drejtimet Gjuhë Angleze, Përkthim dhe Interpretim, Studime Britanike e Amerikane), notë mesatare mbi 9.5;
 - c. Preferohet Cikli i Dytë i Studimeve, "Master i nivelit të dytë" në programet e Gjuhësisë ose Letërsisë (ekuivalentuar me diplomat "Master Ekzekutiv", sipas Ligjit të Arsimit të lartë Nr. 80/2015, Neni 124, pika 5), me notë mesatare mbi 8.5;
 - d. Cikli i Dytë i Studimeve, Master i Shkencave në Gjuhë Angleze (Mësuesi në Gjuhë Angleze, Përkthim dhe Interpretim, Gjuhë dhe Komunikim), notë mesatare mbi 9.5;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



2. Preferohen kandidatë me përvojë mësimdhënie pandërprerje në Institucione të Arsimit të Lartë, minimalisht 5 (pesë) vjet;
3. Preferohen kandidatë të përfshirë në programin e doktoratës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Kandidatët që aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);
2. Kërkesë me shkrim ;
3. Dokument identifikimi;
4. Fotokopje e diplomës (të noteruar);
5. Fotokopje e listës së notave (të noteruar);
6. Dëshmitë për kualifikimet dhe aktivitetet lidhur me temën e aplikimit;
7. Të paktën 2 (dy) referenca nga punëdhënësit e mëparshëm;
8. Në rast të përfundimit të studimeve jashtë vendit kandidati do të paraqesë edhe ekuivalentimin e Diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (të noteruar).
9. Kopje e librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore;
10. Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë;
11. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi;

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejpërdrejta.

Afati i dorëzimit të dokumentave është nga data **15/01/2024 – 29/01/2024**.